REPUBLIKA E KOSOVËS · REPUBLIKA KOSOVA · REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY
Dep. DPK
Nr. Prot 03-02/4189/
Nr. faqe 02
Data 20.12.2017
PRISHTINË

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova - Republic of Kosovo

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**
**ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 18.12.2017, mori:

## V E N D I M

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK–03-02-3519/17, për z. Mehmet Berisha, Kryesues i Njësisë për Administrimin e Kontratave të Shitjes dhe Kontratave të Negocimit Direkt në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, për shkak se i njëjti nuk gjendet në mesin e zyrtarëve të lartë publik.**

**II.** Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

## A r s y e t i m

Agjencia kundër Korrupsionit e ka hap rastin nën dyshimin për konflikt interesi duke u bazuar në formulatër e deklarimit të pasurisë të zyrtarëve të lartë publik, për shkak se z. Berisha është dyshuar se krahas ushtrimit të funksionit publik ushtron njëkohësisht edhe funksion menaxherial në biznes privat. Pas shqyrtimit të këtij rasti është konstatuar se funksioni Kryesues i Njësisë për Administrimin e Kontratave të Shitjes dhe Kontratave të Negocimit Direkt në Agjencinë Kosovare të Privatizimit nuk hynë në kategorinë e zyrtarëve të lartë publik sipas Ligjit nr.04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Ndërkohë, Agjencia ka pranuar një shkresë zyrtare nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (03-02-4097), me të cilën dëshmohet se funksioni Kryesues i Njësisë për Administrimin e Kontratave të Shitjes dhe Kontratave të Negocimit Direkt në Agjencinë Kosovare të Privatizimit i raporton

Drejtorit të Departamentit për Shitje në AKP. Prandaj nuk ka bazë ligjore për trajtim të mëtejshëm të këtij rasti sepse z. Berisha nuk hynë në kategorinë e zyrtarëve të lartë publik.

**II.** Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:
- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit